

## **AKTIVITETI I KRYER NGA SEKTORI I MBIKQYRJES PROFESIONALE PËR VITIN 2014**

Bazuar në ligjin Nr. 9150, Date 30.10.2003 “Për Urdhrin e Farmacistëve të Shqipërisë” janë kryer mbikqyrje profesionale të farmacistëve që ushtrojnë profesionin në subjektet farmaceutike.

Gjate vitit 2014 u mbikqyren rreth 800 farmacistë në rrethet, Tiranë, Durrës, Elbasan, Librazhd, Fier, Lushnjë, Korçë, Pogradec, Berat, Tepelenë, Sarandë, Gjirokastrë, Vlorë. Gjate mbikqyrjeve janë konstatuar shkelje të legjislacionit në fuqi si më poshtë:

- U gjendën farmaci të palicencuara në të cilat shërbenin persona jofarmacistë, konkretisht në Fier dhe në Librazhd, në Tiranë u gjend farmaci pa drejtues teknik në të cilën shërbente person i diplomuar për farmaci por që nuk kishte kaluar me sukses provimin e shtetit.

Për këto raste Urdhri nuk mund të iniciojë masa disiplinore sepse subjektet farmaceutike janë të palicencuara dhe nuk shërbejnë farmacistë, për këtë arsye janë njoftuar institucionet shtetërore kompetente, Ministria e Shëndetësisë, QKKB dhe FSKDSH, por fatkeqësisht nuk ka patur asnjë ndërhyrje për ndërprerjen e aktivitetit nga këto subjekte të paligjshme.

- U gjendën farmaci në të cilat shërbenin persona jofarmacistë, ndihmësfarmacistë ose studentë që janë diplomuar për farmaci por nuk kanë kaluar me sukses provimin e shtetit, konkretisht, në Tiranë, Elbasan, Librazhd, Tepelenë, Berat, Durrës, Fier dhe në Pogradec.

Për të gjitha rastet e evidentuara janë njoftuar institucionet shtetërore, Ministria e Shëndetësisë, QKKB dhe FSKDSH.

Bazuar në Statutin e UFSH, Kodin e Etikës dhe Deontologjisë, drejtuesit teknik të këtyre farmacive janë dërguar për gjykim në komisionet disiplinore të rajoneve.

- Gjithashtu u evidentuan disa farmacistë që kishin kaluar me sukses provimin e shtetit por që nuk kishin zbatuar detyrimin ligjor për tu anëtarësuar në UFSH, dhe farmacistë që u kishte mbaruar afati i rinovimit të certifikatës anëtarësisë në UFSH.
- Në disa raste farmacistët nuk shërbenin në subjektet ku janë certifikuar, kryesisht janë drejtues teknikë në subjekte të caktuara dhe shërbejnë të punësuar në subjekte të tjera.

Për të gjitha këto raste grupet e mbikqyrjes u lanë detyrë dhe afate konkrete.

- Nga komunikimi me koleget u evidentua fenomeni i lidhjeve të paligjshme mjek - farmacist me qëllim përfitimi, duke kequshtruar profesionin, shkelur kodin e etikës deontologjike mjekësore e farmaceutike, por edhe duke konkuruar në mënyrë të pandershme.

Nëse marrim parasysh faktin se janë mbikqyrur vetëm një pjesë e farmacive të vendit, dhe se në bazë të informacioneve shkeljet janë më të shumta gjatë ditëve të pushimit dhe jashtë orarit zyrtar( më i theksuar është fenomeni i dhënies së shërbimit farmaceutik nga persona që studiojnë për farmaci dhe të diplomuar për farmaci por që nuk kanë kaluar me sukses provimin e shtetit, ky fenomen është më i përhapur në Tiranë) situata mund të konsiderohet shumë shqetësuese. Për shkak të rritjes së pandalshme të nr të farmacistëve dhe farmacive , shpërndarjes territoriale, burimeve njerëzore dhe mjeteve të kufizuara që disponon Zyra Qendrore e UFSH, është e pamundur që të evidentojmë në kohë reale shkeljet e mundshme gjatë ushtrimit të profesionit të farmacistit, prandaj kërkohet që në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe statutore këshillat rajonale të marrin rolin e tyre si në evidentimin e rasteve të shkeljeve, marrjen e masave për rastet konkrete dhe dërgimin e informacionit pranë zyrës Qendrore.

Në funksion të zbatimit te legjisllacionit farmaceutik, ruajtjes se cilësisë së lartë të shërbimit farmaceutik dhe zbatimit të Statutit e Kodit të Etikës e Deontologjisë, Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë i është drejtuar në vazhdimësi institucioneve shtetërore kompetente për krijimin e urave të bashkëpunimit por me përjashtim të një predispozicioni nga FSKDSH (i pakonkretizuar) nuk kemi asnjë sinjal bashkëpunues nga AKBPM.